

28.06.2013



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## KOMUNIKATË PËR MEDIA – BORDI I DREJTORËVE I AKP-së

Agjencia Kosovare e Privatizimit, pas funksionalizimit të Bordit me përbërjen e re në muajin shkurt ka rifilluar me përmbylljen e plotë të përgjegjësisve të saj. Gjatë tre muajve të fundit ka pasur angazhime të shumta në drejtim të shtyrjes përpara të procesit të privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore. Gjatë këtij tremujori janë përmbyllur dy valë të privatizimit të NSh-ve (vala 57 dhe vala 58) me gjithsej 54 ndërmarrje të reja, si dhe një valë e shitjes së aseteve me likuidim nr.19 me mbi 30 asete. Është shënuar një angazhim më i madh në procesin e likuidimit, përgatitjen e listave të punëtorëve dhe shpërndarjen e 20%, përmbylljen e shitjeve si në ndërmarrjet me interes të veçantë siç është Trepça.

Nga privatizimet dhe shitjet e aseteve deri më tani janë mbledhur në total mbi 635 milionë Euro, nga privatizimi rreth 566 milionë Euro, ndërsa nga shitja e aseteve me likuidim rreth 69 milionë Euro. Këto fonde janë të deponuara në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe deri më tani nga normat e interesit fondet janë rritur rreth 34.6 milionë Euro, përkundër krizave në tregjet financiare ndërkombëtare.

Për sa i përket përmbylljes së privatizimeve, AKP ka arritur të përshpejtoj gjithë procesin dhe të evitoj pritjet e blerësve për të nënshkruar kontratat me AKP. Vetëm gjatë këtij tremujori janë nënshkruar mbi 50 kontrata me blerësit, prej tyre 10 kontrata janë të nënshkruara nga privatizimi me metodën Spin-Off, kurse 40 kontrata janë nga shitjet e aseteve me likuidim. Në total numri i kontratave të nënshkruara ka arritur në shifrën 1059.

Vetëm në periudhën prill-qershor 2013, Agjencia ka fut në procesin e likuidimit 99 ndërmarrje shoqërore, që paraqet një progres të madh përse i përket përfshirjes së ndërmarrjeve në procesin e likuidimit, ndërkohë që ka hartuar raportin përfundimtar të procesit të likuidimit të NSh. SH.A.M “Semafori”, nga Suhareka. Tani në likuidim janë gjithsej 274 ndërmarrje shoqërore. Likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore është intensifikuar me angazhimin e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale si dhe me funksionalizimin e plotë të stafit në të gjitha zyrat regjionale dhe satelitore të AKP-së. Një shtytje të veçantë ka dhënë themelimi i komisionit mbikëqyrës gjatë këtij tremujori, i cili në masë të madhe ka ndihmuar këtë proces të rëndësishëm për likuidimin dhe shpërndarjen e parave nga privatizimi.

Agjencia ka aprovuar gjatë këtij tremujori edhe 28 lista të punëtorëve të NSh-ve dhe deri më tani në total Agjencia ka shpërndarë mbi 74 milionë euro nga pjesa e 20 %, kurse kanë përfituar rreth 36 mijë e 300 (ish) punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara. Vlen të përmendet shpërndarja e 20 % për punëtorët e ndërmarrjes shoqërore “Ramiz Sadiku” në Prishtinë, me gjithsej 1281 punëtorë të kualifikuar në listën e punëtorëve të kësaj ndërmarrje të cilëve iu shpërndanë rreth 3.6 milionë Euro, e që paraqet ndër listat më të mëdha për nga numri i punëtorëve dhe për nga shuma e mjeteve të shpërndara deri më tani. Agjencia është e

gatshme të bëjë shpërndarjet e tërësishme të 20 % për punëtorët posa të lëshohen vendimet përfundimtare nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

AKP, si administratore e ndërmarrjes shoqërore Trepça, në kuadër të përgjegjësisë të saj ka shënuar angazhime shtesë me qëllim të arritjes së afateve ligjore sipas ligjeve në fuqi. Sipas ligjit për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë të Tyre si dhe vendimeve të Odës së Veçantë, Agjencia si administratore e Ndërmarrjes Trepça është e obliguar të shpall publikimin për pranimin e kërkesave të kreditorëve më 1 nëntor 2013 dhe t'i dorëzoj Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës planin e riorganizimit dhe revitalizimit të Trepçës diku në mes të vitit 2014. Në këtë kontekst, gjatë këtij tremujori Agjencia ka punuar intensivisht në përgatitjet për angazhimin e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale për të ndihmuar në arritjen e këtyre objektivave dhe së shpejti termat e referencës për këtë qëllim do të jenë gati për procedurat e mëtejme. Ndërkohë, Trepça ka vazhduar me punën e saj të zakonshme të prodhimit dhe shitjes së koncentratit, si dhe koordinimit më të mirë të punëve me AKP-në. Gjithashtu, është rritur efikasiteti i Odës së Veçantë lidhur me vendimet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës në Trepçë si dhe është rritur bashkërendimi dhe bashkëpunimi në mes të AKP-së dhe Odës së Veçantë.

Agjencia ka vazhduar me shitjen e banesave të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore sipas Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, dhe gjatë tremujorit ka miratuar shitjen e 91 banesave. Ky proces i shitjes së banesave në pronësi të NSh-ve është i rëndësishëm dhe i ndihmon procesit të likuidimit të atyre NSh-ve.

Në kuadër të obligimeve ligjore, Agjencia gjatë vitit tremujorit ka aprovuar edhe Raportin Vjetor për vitin e shkuar, i cili së shpejti do t'i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Agjencia në vazhdim do të fokusohet në realizimin e planit të punës të aprovuar së fundi nga Bordi i saj, i cili është ambicioz dhe parasheh intensifikim të aktiviteteve për përmbyllje të suksesshme të procesit të privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore.

## FUND